

VENDIM
Nr.978, datë 8.10.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.857, DATË 5.8.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR HAPJEN NË QYTETIN E PESHKOPISË TË FILIALEVE DHE
PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË FAKULTETEVE TË EKONOMISË E TË
ADMINISTRIMIT, TË EDUKIMIT DHE TË SHKOLLËS SË LARTË PROFESIONALE
TË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS, SI DHE PËR MIRATIMIN
E KUOTAVE TË PRANIMIT TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME
STUDIMI, NË VITIN AKADEMIK 2009-2010”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pikat 1.11 e 2, shkronja “b”, 26, 33, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 8 e vendimit nr, 857, datë 5.8.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“8. Numri i kuotave të pranimeve, në këto programe studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë, për vitin akademik 2009-2010, është përcaktuar në tabelën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA E KUOTAVE TË PRANIMIT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË
PARË ME KOHË TË PLOTË TË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS
(FILIALI PESHKOPI)

Nr.	PROGRAMET E STUDIMIT	KUOTAT
	FAKULTETI I EKONOMISË DHE I ADMINISTRIMIT	
1	Shkenca të Administrimit (profil Financë-Kontabilitet)	30
2	Shkenca të Administrimit (profil Financë- Bankë)	30
3	Shkenca të Administrimit (profil Menaxhim-Marketing)	30
4	Shkenca të Administrimit (profil Administrim-Biznesi)	30
	FAKULTETI I EDUKIMIT	
1	Informatikë-Anglisht	30
2	Gjuhë-Letërsi-Anglisht	30
3	Matematikë-Fizikë	30
4	Matematikë-Informatikë	30
5	Biologji-Kimi	30
6	Psikologji-Sociologji	30
7	Procese formimi	30
	SHKOLLA E LARTË PROFESIONALE	
1	Drejtësi (Asistent ligjor)	30
2	Infermieri e përgjithshme (3-vjeçare)	30
3	Informatikë (Specialist Rrjetash Kompjuterike)	30
	Gjithsej	420

